



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:177285
Datë: 22.10.2024
Numri i dokumentit: 06334263

C.nr.145/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. H. nr. personal, nga fshati S. i E., Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson i autorizuari B. S., avokat nga Podujeva, Rruga “B.F.” pn., me autorizim, kundër të paditurit 1. A. E. nr. personal, dhe Bashkim Emmini nr. personal, të cilin e përfaqëson i autorizuari A. E., të dy nga fshati S. i E., Komuna e Podujevës, baza e kontestit: Vërtetimin e pronësisë, me vlerë kontesti prej 5,000.00€uro, jashtë seance me datë 18.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPREHET, procedura sipas padisë së paditësit S. H. nga fshati S. i E., kundër të paditurit 1. A. E., dhe B. E., të dy nga fshati S. i E., Komuna e Podujevës.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdohet pasi që të zgjidhet çështja paraprake dhe paditësi me parashtrësë i propozon gjykatës që të vazhdojë procedura.

A r s y e t i m

Paditësi K. V. nga Prishtina, Lagjja “D.”, sheshi “B. K.”, H-B., kati ...-të, nr....., ka paraqitur me datë 24.03.2017, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë, kundër të paditurit 1. A. E., dhe B. E., të dy nga fshati S. i E..

Paditësi-i autorizuari ka theksuar se nga pala paditëse jam njoftuar se për çështjen e ndryshimit të këtyre koordinatave gjë për të cilën është thirrë që nga fillimi i kësaj procedure, ka dorëzuar prova i njëjti, pala ka iniciuar rastin në Polici dhe në prokurori për ti hetuar manipulimet e mundshme në ndryshimin e koordinatave lidhur me parcelën kontestuese nga zyrtarët përkatës. Andaj, pas konsultimit me paditësin propozojmë gjykatës që procedura të ndërprehet deri sa të zgjidhet çështja parapaka siç deklaroam.

I padituri në të përgjigjur në padi ndër tjera ka theksuar se e kundërshtoi kërkesën për ndërpreje të procedurës dhe revokimin e aktvendimit për ekspert.

Procedura në këtë çështje ndërprehet derisa të zgjidhet çështja paraprake në çështjen lidhur me ndryshimin e mundshëm të koordinatave lidhur me ngastrat kontestuese, në të cilën ende nuk është marrë vendim.

Andaj, gjykata duke mos pasur kushte për të zhvilluar procedurën kontestimore dhe vendosjen sipas padisë, në një gjendje të tillë e në kuptim të nenit 278.1 pika a) lidhur me nenin 13 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), e ndërpreu procedurën në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata e ndërpret gjykimin: po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake (neni 13 i këtij ligji);”*

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë në kuptim të dispozitave të nenit 280.4 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, gjykata do të veproj sipas kërkesës së paditësit për vazhdimin e procedurës, pas zgjidhjes së çështjes paraprake.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.145/2017 me datë 18.10.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.